



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.47, datë 23.02.2023

PËR

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKUROREN
ERVISA HYKA, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a” dhe 189, pika 1 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 32 dhe nenin 48 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 9, pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, Kreun VI, Seksioni Ç, pikën 8, germa “ç”, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren Ervisa Hyka, candidate për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Ervisa Hyka, candidate për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidates prokurore Ervisa Hyka të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Ervisa Hyka.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 23.02.2023.



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani



ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza

